



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
DHOMA E NOTEREVE VLORE



**Notere Leidia SHPATA**

Zyra Noteriale Fier  
Nr. Nipti L32518403K  
Nr. License 523

Nr. 145 Rep.  
Nr. 7B Kol.

**KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH**

Ne Fier, sot me date 21.01.2019 ( dymije e nentembehjete ) , ne Zyren e Noterise, qe ndodhet ne lagjen "K. e Pezes " Rr " Dervish Hekali", para meje noteres Leidia SHPATA u paraqiten personalisht , palet e meposhtme:

**ERJONI – AGRO shpk**, person juridik me zyre qendrore ne fshati Strum, rruga nacionale Fier-Berat km 18 regjistruar ne regjistruin themeltar pajisur me nr. NUIS L62818403A , perfaqesuar nga administratori **Erjon Prifti** , atesia **Trifon**, i datëlindjes 06.12.1982 lindur ne Strum e banues ne Strum Fier, madhor e me zotësi te plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr.025082536 dhe nr. Personal I21206009F

( qe ketu e me poshte ne kete kontrate do te quhet SHITESI, dhe.

**JULIAN HAZIZI** atesia Teki , lindur me 08.06.1988 ne Strum Fier dhe banues ne Strum Fier me shtetesi shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar identifikuar me leternjoftim me nr. personal I80608027G (qe ketu e me poshte ne kete kontrate do te quhet **BLERESI**).

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash si me poshte :

Shitesi Erjon Prifti eshte administrator dhe ortak i vetem i shoqerise "ERJONI-AGRO" shpk zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 leke, qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise ERJONI-AGRO shpk shpk, e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik, prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me nr. Nipti L62818403A

Me vullnet te lire e te plote te administratorit dhe Vendim te ortakut te vetem te shoqerise ERJONI-AGRO shpk ka vendosur transferimin nepermjet shitblerjes te kuotave te zoteruara prej tij ne shoqeri ne favor te z. Julian Hazizi

- Kuotat e shoqerise jane te lira dhe nuk ka asnjë barre ne ngarkim te tyre.

**Objekti i kontrates**

Referuar statutit te shoqerise, ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori dhe ortakut i vetem Erjon Prifti zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 leke, qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise "ERJONI-AGRO shpk " shpk, transferon me vullnet te lire e te plote, nepermjet shitjes ne favor te blesit Julian hazizi 1 kuote e cila perfaqeson 100 % te kapitalit ne shoqerine "ERJONI-AGRO shpk " shpk.

**Cmimi i shitjes**

Çmimi i shitjes se 100 % te kapitalit te zoteruar nga ortakut i vetem Erjon Prifti dhe qe transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakut te ri Julian Hazizi eshte 100 leke dhe perben 100 % te kapitalit te shoqerise.

Bleresi ka paguar sipas paragrafit te mesiperem plotesisht çmimin e shitjes jashte kesaj zyre noteriale, dhe shitesi deklaroi se e ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim. Monedha e përcaktuar per kryerjen e ketij trasaksioni eshte leku

### Garancite

Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar, çdo barre, apo sekuestro ose pengese tjeter ligjore ne favor te te tretteve, vertetuar edhe nepermjet regjistri i Barreve Siguruese ne Tirane nepermjet konfirmimit me rezultat kerkimi 0, dhe për çdo pretendim qe mund te ngrëne te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palës blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

### Heqje dore nga te drejtat

Shitesi deklaroi nen pergjegjesine e tij personale se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne mbi kuotat e transferuara nepermjet kesaj kontrate, duke u larguar perfundimisht si administrator dhe ortak i vetem nga shoqeria “ ERJONI-AGRO shpk “ te drejta qe kalojne tek administratori i ri i shoqerise dhe ortak i vetem Julian Hazizi.

### Te ndryshme

Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi Julian Hazizi, behet pronar i ligjshem i 1 kuote , me vlere te pergjithshme 100 leke qe perfaqeson 100 % te kapitalit ne shoqeri, ndersa shitesi Erjon Prifti largohet nga shoqeria dhe zhvishet teresisht nga cdo e drejte dhe detyrim ne shoqerine “ ERJONI – AGRO ” shpk.

Kjo kontrate u hartua ne baze te ligjit n. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” .Sa parashikuar ne dispozitat kontraktuese te mësipërme, ne përputhje me nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar.

Kontrata u hartua ne kater ekzemplare origjinale me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe. Palet deklaruan se jane dakort me sa me siper, dhe pasi e degjuan, e kuptuan, e nenshkruan regullisht perpara meje dhe une noterja Leidia SHPATA e vertetoj ate sipas ligjit.

PALET KONTRAKTORE

PALA SHITSESE

Erjon Prifti



PALA BLERESE

Julian Hazizi

NOTERE

LEIDIA SHPATA



Leidia Shpata

SHOQERIA " ERJONI – AGRO « shpk ,  
NUIS L62818403A



**VENDIM**  
I ORTAKUT TE VETEM  
TE SHOQERISE " ERJONI-AGRO shpk "  
Nr. 1 Date 21.01.2019

Ne seline e shoqerise, u mblodh Ortaku i shoqerise "ERJONI-AGRO" shpk  
me pjesemarrjen e :

Ortakut Erjon Prifti zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100 leke, qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise,

*e cila zhvilloi mbledhjen e saj me rend dite :*

- Largimin nga shoqeria te administratorit dhe ortakut te vetm Erjon Prifti dhe transferimin nepermjet shitjes te kuotave te zoteruara prej tij ne shoqeri ne favor te z. Julian Hazizi..

Ne perfundim, pas shqyrtimit te rendit te dites, mbeshtetur ne ligjin " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", asambleja e ortakeve,

**VENDOSI**

Largimin nga shoqeria te ortakut Erjon Prifti , dhe transferimin nepermjet shitjes te 1 kuote te zoteruar prej saj ne shoqeri, me vlere te pergjithshme 100 leke, qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise, dhe ndryshimin dhe caktimin e administratorit te ri Julian Hazizi.  
Reflektimin e ndryshimeve te mesiperme ne aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise.

Autorizohet z. Julian Hazizi te depozitoje vendimin, dhe statutin e ndryshur sipas ligjit 9901 date 14.04.2008 „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare „ dhe ligjit 9723, date 3.5.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", prane QKB per te pasqyruar ndryshimet e mesiperme ne skeden e shoqerise.

ORTAKI I VETEM

*Erjon Prifti*

